



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
 DHE ËSHTË I PRAVNOSNAZHNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROŠEVAC

Më  
 Data 25 - 06 - 2018

P.nr.58/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - Divizioni penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Faton Ajvazi si dhe me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaj, rr [REDACTED], nr [REDACTED] për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, nën par 1.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/I.nr.196/15, të dt.29.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të dëmtuarit [REDACTED] dhe të pandehurit [REDACTED] me datë 20.11.2017 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë. 05.12.2017 përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] me vendbanim në Ferizaj, rr [REDACTED], nr. [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, fermer, i punësuar në optikën [REDACTED], i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse

Më datë 20.11.2015, rreth orës 18:10, në rrugën “Medlin Olbrajt”, në Ferizaj, afër “As Centrumit”, i pandehuri së bashku me të miturin [REDACTED], rastësisht janë takuar me të dëmtuarin [REDACTED] i cili po kthehej nga kursi i gjuhës gjermane, në atë moment i pandehuri [REDACTED] i drejtohet me fjalët të dëmtuarit “pse po më këqyr shtrembër” dhe menjëherë nxjerrë një thikë ngjyrë të zezë, mjet ky i rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të lehtë trupor dhe e godet njëherë në gishtin e madh të dorës së djathtë, më çka nga goditjet i dëmtuari [REDACTED] merr lëndime të lehta trupore plagë prerëse në shuplakën e dorës së djathtë.

Me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, nën par 1.1, të KPRK-së

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 7, 8, 9, 17, 21, 41, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, të cilin dënim detyrohet që ta mbaj pasi aktgjykimi ta merr formën e prerë.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 euro si dhe paushalli gjyqësorë në shumë prej 20 euro, në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

I dëmtuari [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m i

### 1. Historiku i procedurës

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/L.nr.196/15, të dt. 29.01.2015, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, nën par 1.1, të KPRK-së, si dhe mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe të i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni penal, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 20.11.2017, në të cilën fazë i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për veprën penale për të cilën akuzohet.

## 2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale a lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, nën par 1.1, të KPRK-së.

I njëjti ka deklaruar: *se përveq ditës kritike me të dëmtuarin nuk kam pasur probleme e as nuk e kam njohur më parë, se ditën kritike unë me shokun tim [REDAKTUAR] ishim duke ecur rrugës bashkë nga rruga e Pleshinës ka qyteti dhe ne rr "Medlin Oibrajt" tem market Meridiani jemi takuar me të dëmtuarin ku i njëjti na ka thënë me fjalët "qka po mi zverdhon sytë" dhe e pyeta a po më njeft mua dhe unë iu afrova dhe në atë moment kur unë iu afrova i dëmtuari e ka goditur shokun tim [REDAKTUAR] dhe aty jemi rrahur me grushta ku ka zgjatur diku 5 minuta dhe në atë moment i dëmtuari e ka nxjerrë një thikë të zezë dhe unë me shokun tim kemi ikur ku gjatë ikjes shoku im [REDAKTUAR] pas diku 5-6 metra është rrëzuar në tokë dhe i dëmtuari [REDAKTUAR] ishte mbi shokun tim dhe unë duke e parë këtë dhe unë me qelës të derës së lokalit jam afruar tek i dëmtuari e kam goditur dhe siq e di e kam goditur në kokë, në atë moment [REDAKTUAR] është rrëzuar dhe unë me shokun tim jemi larguar. Nuk e kam parë që shoku im ka pasur thikë në dorë përveq në stacion të policisë ma kanë treguar një thikë të vogël të cilën e kanë gjetur në vend të ngjarjes dhe kjo thikë nuk është ajo të cilën e kam cekur më herët që kishte ngjyrë të zezë.*

## 3. Deklarata e të dëmtuarit

I dëmtuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: mosmarrëveshjet me të pandehurin kanë ndodhur në ditën kur isha duke u kthyer nga kursi i gjuhës Gjermane, dhe para Mobi Shop "Haxhia" në rr. "Medlin Ollbrajt" i padehuri bashkë me [REDAKTUAR] është ndalur dhe më ka thënë se pse po më shikon mua dhe pas asaj unë e kam kthyer kokën kah rruga kah isha duke ecur ku isha duke shkuar në fsh. Pleshinë në një të pame, dhe veç kur e kam dëgjuar ku si e kam kthyer kokën i pandehuri më ka sulmuar kah fytyra me thikë, thika ka qenë ngjyrë e zezë dhe duke u mbrojtur me duar i pandehuri me thikë ma ka lënduar edhe gishtin e madhe të dorës së djathtë dhe gërvishtje kam pasur në fytyrë, në kokë dhe në buzë, ku buzën e kam pasur të qamë dhe pasi jam rrëzuar në tokë lëndimet në krahë dhe shpinë dysjoj se janë të shkaktuara nga të dytë, i pandehuri [REDAKTUAR] si dhe [REDAKTUAR] dhe kur kam rënë në tokë një kohë nuk kam pasur vetëdije, dhe ndihmën e parë më ka ofruar një

djalë i cili jeton në rrugën e Pleshinës të cilit emrin nuk ja dijë. Prezentë aty kanë qenë edhe shumë njerëz ku në mesin e tyre ka qenë edhe pronari i Mobi Shop "Haxhia".

4. Deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili ka deklaruar se të akuzuarin nuk e ka parë asnjëherë kurse të dëmtuarin e ka parë disa herë kur ka ardhur për të blerë ndonjë telefon dhe në rr "Medlin Olbrajt" e kam lokalin tim dhe punoj në atë lokal që nga viti 2000 dhe ditën kritike me dt. 20.11.2015, meqenëse lokali im është më larg se sa vendi ku ka ndodhur rasti unë kam dëgjuar disa britma dhe kam dalë që në atë moment e kam hapur derën e lokalit dhe kam shikuar se çka është duke ndodhur ku i kam parë disa njerëz të tubuar dhe pas 3-4 minutave sërish e kam nxjerr vetëm kokën jashtë në derë të lokalit dhe atë e kam parë përball lokalit tim të dëmtuarin i cili ishte duke ecur në këmbë, duke mbajtur krahun ku një person afër tij duke e shikuar dhe duke e pyetur se a është i lënduar, duke e lutur për ndihmë atëherë personi i lënduar e ka ngritur krahun përpjetë dhe në atë moment dritaret e lokalit janë spërkatur me pika të gjakut, askënd përveç të dëmtuarit nuk e kam parë atë ditë ashtu që policia aty kanë ardhur pas 30-40 minuta.

### 3.Fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit

I cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë si dhe shqyrtimeve paraprake nga provat e administruara siç janë dëshmia e dëshmitarëve, të dëmtuarit, mbrojtja e vetë të pandehurit si dhe provave materiale nuk është kontestues fakti që i pandehuri të dëmtuarin e ka goditur me mjet të fortë me çka me veprimet e tij konsideroj se janë përmbushur elementet e figurës së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, të KPRK-së, andaj i propozoj gjykatës që të pandehurin për këtë vepër ta shpall fajtor.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar : e përkrahi fjalën përfundimtare të Prokurorit të shtetit, i bashkëngjitëm ndjekjes penale si dhe paraqes kërkesë pasurore juridike.

### 4. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, të KPRK-së, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëriën me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit;
- nga fotografitë e vendit të ngjarjes përkatësisht fotot e vendit të ngjarjes, fotot mbi lëndimet e marra nga i dëmtuari [REDAKTUAR];
- nga raporti mjekësor i dt.20.11.2015, në emër të [REDAKTUAR] i lëshuar nga Qendra Emergjente në Ferizaj,
- Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i lëshuar nga Policia e Kosovës-Njësia e Forenzikës i datës 20.11.2015,
- si dhe nga provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

#### 5. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Më datë 20.11.2015, rreth orës 18:10, në rrugën "Medlin Olbrajt", në Ferizaj, afër "As Centrumit", i pandehuri së bashku me të miturin [REDAKTUAR] rastësisht janë takuar me të dëmtuarin [REDAKTUAR] i cili po kthehej nga kursi i gjuhës gjermane, në atë moment i pandehuri [REDAKTUAR] i drejtohet me fjalët të dëmtuarit "pse po më këqyr shtrembër" dhe menjëherë nxjerrë një thikë ngjyrë të zezë, mjet ky i rrezikshëm që mund të shkaktoj lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të lehtë trupor dhe e godet njëherë në gishtin e madh të dorës së djathtë, më çka nga goditjet i dëmtuari [REDAKTUAR] merr lëndime të lehta trupore plagë prerëse në shuplakën e dorës së djathtë.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi duke u bazuar pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit, nga dëshmia e dëshmitarit si dhe nga dëshmia e të dëmtuarit si dhe nga provat të tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi edhe gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **6. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Mbrojtja e të akuzuarit në fazën e shqyrtimit gjyqësor se me të dëmtuarin jemi rrahur me grushta dhe në atë moment i dëmtuari e ka nxjerrur një thikë të zezë dhe unë me shokun tim kemi ikur, nuk qëndron pasi nga provat e paraqitura në shqyrimin gjyqësor shihet se i akuzuari nga përlëshja me të dëmtuarin të njëjtin e ka goditur në gishtin e madh të dorës së djathtë me çka nga goditjet i dëmtuari [REDACTED] ka marr lëndime të lehta trupore edhe atë në shuplakën e dorës së djathtë ku një fakt të tillë e ka pranuar pjesërisht edhe vet i pandehuri i cili vet ka deklaruar se e ka goditur të dëmtuarin me mjet të fortë por siq ka deklaruar në kokë.

#### **7. Vlerësimi i deklaratës së të dëmtuarit**

Gjykata vlerësoi dëshminë e dëshmitarit – të dëmtuarit pasi e njëjta deklaratë nuk është kontradiktore me deklaratën e dhënë në polici si dhe e njëjta përputhet edhe me provat – fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

#### **8. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit**

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188, par 2, lidhur me par 1, të KPRK-së.

#### **9. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari deri më tani nuk ka qenë i padënuar me aktgjykim të formës së prerë.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-së, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), se përmes këtij

dënimi do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**10.Kerkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale**


I dëmtuari [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-së gjykata e obligoj të pandehurin që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 euro si dhe paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 euro, brenda afatit prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
Divizioni penal P.nr.58/16, me datë 05.12.2017**

Sekretarja juridike,  
Makfire Reçica

Gjyqtari Individual,  
Faton Ajvazi  


**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.